



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



| |
|---|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTORATI ZA ADMINISTRACIJU |
| Identifikuesi për: 1075 |
| Data/Data: 16.07.2018 |
| KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE |

Datë: 16.07.2018

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 16, nenin 17, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 117, të datës 11.06.2018, bën këtë:

**NJOFTIM
PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK PËR PROJEKT-
RREGULLOREN PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE**

Njoftohen qytetarët dhe të gjithë të interesuarit e tjerë që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Komunën e Fushë-Kosovës, se diskutimi publik për “Projekt-Rregulloren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Komunën e Fushë-Kosovës”, është i hapur nga data: 16.07.2018-29.07.2018.

Për sqarime dhe konsultime lidhur me “Projekt-Rregulloren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Komunën e Fushë-Kosovës”, mund të drejtoheni në Njësitin për të Drejtat e Njeriut, kati përdhes, në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës, rruga ‘Tahir Zemaj’.

Takimi për konsultim publik do të mbahet më datë: **23.07.2018, në orën 10:00h**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në ndërtesën e Komunës.

Njoftimi për diskutim publik publikohet në ueb-faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

Përshëndetje!





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FUSHË-KOSOVË
OPŠTINA KOSOVO POLJE / MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVO



RREGULLORE

PËR

**MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE PËRMES QEVERISË KOMUNALE
PËR TË KRIJUAR NJË AMBIENT MIQËSOR PËR FËMIJËT**

Fushë-Kosovë, Maj 2018

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafin 12.2, shkronja (c), nenin 17, shkronja (s), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), të Statutit të Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 98, të datës 17.08.2012, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur _____ 2018, miratoi këtë:

PROJEKT-RREGULLORE

PËR

MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE PËRMES QEVERISË KOMUNALE PËR TË KRIJUAR NJË AMBIENT MIQËSOR PËR FËMIJËT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton masat për realizimin, mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve (vajzave dhe djemve), përmes qeverisë komunale dhe kontribuon në krijimin e një 'Komune mike për fëmijët'.
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjithë fëmijët, pa dallim, pavarësisht: racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo ndonjë mendimi tjetër, origjinës kombëtare, përkatësisë etnike, statutit social dhe ekonomik, paaftësisë së kufizuar, prejardhjes familjare të fëmijëve, prindërve të tyre apo kujdestarëve ligjorë dhe shtrihet në të gjitha institucionet të cilat janë nën administrimin e Komunës së Fushë-Kosovës apo veprojnë brenda territorit të komunës, përderisa pavarësia e tyre nuk cenohet në përputhje me ligjet në fuqi.
3. Kjo Rregullore është kontribut për të siguruar se Komuna e Fushë-Kosovës, hap pas hapi, po ndërton një shoqëri të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.

Neni 2

Përkufizimi i fëmijës

1. Fëmijë konsiderohet secili person nën moshën 18 vjeç.
2. Fëmijët deri në moshën 18 vjeçare i gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre ashtu siç parashihen në 'Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës', e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe në Konventat dhe Standardet tjera të zbatueshme që sigurojnë realizimin progresiv të të drejtave të tyre.
3. Fëmijët janë kategori e veçantë të cilët për shkak të moshës, zhvillimit psiko-fizik dhe edukativo-arsimor, por edhe socio-ekonomik, duhet t'i realizojnë të drejtat e tyre me mbështetjen e të rriturve.

4. Prindërit, familjet, kujdestarët dhe institucionet shtetërore mbajnë përgjegjësinë kryesore për realizimin e të drejtave të fëmijëve për të siguruar ruajtje dhe kujdes të veçantë, përfshirë mbrojtjen e duhur ligjore para dhe pas lindjes së tyre.

Neni 3

Parimet e përgjithshme për të drejtat e fëmijës

1. 'Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës' (në tekstin e mëtejme Konventa) i obligon shtetet që t'i sigurojnë të drejtat e fëmijës në mënyrë të plotë siç janë përcaktuar në Konventë.
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, legjislacioni dhe aktet nënligjore, udhëhiqen nga parimet e Konventës:
 - 2.1. **Mosdiskriminimi** - Nënkupton se të gjithë fëmijët brenda juridiksionit lokal i gëzojnë të drejtat e barabarta, pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, mendimit politik, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare apo sociale, statusit ekonomik të fëmijës, prindërve, apo kujdestarit ligjor.
 - 2.2. **Interesat më të mira të fëmijës** - Nënkupton se në rast të ndonjë vendimi nga ana e institucioneve së pari do të merret parasysh interesi më i mirë i fëmijës i cili është subjekt i vendimit.
 - 2.3. **E drejta e jetesës, mbijetesës dhe zhvillimit** - Nënkupton sigurimin e një jete sa më cilësore për fëmijët, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë mendor, emocional, social dhe kulturor.
 - 2.4. **Pikëpamjet e fëmijës** - Nënkupton lirinë e fëmijëve për t'i shprehur pikëpamjet e tyre për çështjet që lidhen me ta, obligimin e institucioneve për t'i dëgjuar këto pikëpamje dhe për t'i marrë parasysh ato kur të marrin vendime që ndikojnë tek këta fëmijë, gjithmonë në përputhje me nivelin e zhvillimit të fëmijës.
3. Parimet e Konventës zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në legjislacionin vendor.

DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 4

'Komuna mike për fëmijët'

1. 'Komuna mike për fëmijët' është një sistem i qeverisjes së mirë lokale, e angazhuar për zbatimin e plotë të Konventës dhe transformimin e saj në praktikën e përditshme.
2. 'Komuna mike për fëmijët' i garanton secilit fëmijë që do të:
 - 2.1. Merr pjesë dhe ndikoj në vendimet e komunës së vet;
 - 2.2. Shpreh pikëpamjet e tij/saj për komunën që do;
 - 2.3. Merr pjesë në jetën sociale dhe familjare të komunitetit;

- 2.4. Merr shërbimet për mbrojtjen sociale, kujdesin shëndetësor, arsimin dhe kujdesin alternativ;
- 2.5. Ketë qasje në ujë të pastër për pije dhe në higjienën e duhur;
- 2.6. Jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi, punët e rënda, dhuna dhe abuzimi, apo çfarëdo rreziku tjetër cenues, për shkak të moshës apo gjinisë;
- 2.7. Ketë lëvizje të sigurt në rrugë;
- 2.8. Ketë mundësi për takime dhe lojëra me shokët;
- 2.9. Jetojë në një mjedis të pastër;
- 2.10. Merr pjesë në ngjarjet edukativo-arsimore, kulturore, sportive dhe sociale;
- 2.11. Jetë qytetar i barabartë i komunës, me qasje në secilin shërbim, pavarësisht përkatësisë etnike, fetare, ekonomike, sociale, gjinisë apo aftësisë.

Neni 5

Përgjegjësitë për të drejtat e fëmijës

1. Realizimi i të drejtave të fëmijës është përgjegjësi e familjes dhe institucioneve shtetërore, qofshin ato qendrore apo lokale.
2. Çdo zyrtar publik, institucion komunal, institucion nga niveli qendror, që vepron në nivelin komunal dhe çdo subjekt tjetër që ndërlihet me fëmijët, kanë përgjegjësi sociale dhe ligjore për t'u angazhuar në mbrojtjen, promovimin dhe zbatimin e të drejtave të fëmijës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe konceptin e 'Komunës mike për fëmijë'.
3. Lista e palëve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës në komunë përfshin:
 - 3.1. Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, Drejtoritë Komunale;
 - 3.2. Organet e drejtësisë për fëmijë (Policia, Prokuroria, Gjykata, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, etj);
 - 3.3. Njësitin për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në Komunë;
 - 3.4. Qendrën për Punë Sociale;
 - 3.5. Institucionet shëndetësore, publike dhe private;
 - 3.6. Shkollat, përfshirë të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit

parauniversitar dhe mekanizmat që veprojnë brenda shkollave:

- 3.6.1 Këshillin e arsimtarëve;
- 3.6.2 Këshillin e nxënësve;
- 3.6.3 Këshillin e prindërve;
- 3.7. Klubet, shoqatat sportive dhe kulturo-artistike;
- 3.8. Institucionin e Avokatit të Popullit (Ombudspersoni);
- 3.9. Bashkësitë lokale fetare;
- 3.10. Organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare që operojnë brenda territorit të komunës;
- 3.11. Komunitetin apo shoqatat afariste dhe të bizneseve.

Neni 6

Njësi për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në fushën e të Drejtave të Fëmijëve

1. Shërben si organ për vendosjen e prioriteteve dhe sistemeve të sigurimit të cilësisë për formësimin e çështjeve dhe zgjidhjeve për fëmijë, veçanërisht për vënien në praktikë të angazhimeve dhe veprimeve të politikave ekzistuese në hartimin e politikave komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
2. Krijon mjedis mundësues për përgatitjen e planeve për të drejtat e fëmijëve, planifikon buxhet dhe përcjell zbatimin e planeve.
3. Është përgjegjës për angazhimet e Kuvendit të Komunës për politikat dhe shërbimet për të drejtat e fëmijëve.
4. Promovon konceptin e ‘Komunës mike për fëmijët’ dhe praktikat e përkufizuara sipas mjeteve dhe udhëzimeve të krijuara;
5. Siguron që të gjitha aspektet e kornizës ligjore të cilat janë nën përgjegjësinë e Komunës t’i zbatojë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ndërkohë, vepron si një mbështetës i fuqishëm i fëmijëve duke u bazuar në legjislacionin në fuqi;
6. Kryen vetëvlerësime periodike të cilat rezultojnë me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga komuna, në mënyrë që të krijohet një ‘Komunë mike për fëmijë’;
7. Udhëheq procesin e Hartimit të Planit të Veprimit për Fëmijë në baza vjetore dhe vëzhgon zbatimin e tij, bazuar në vetëvlerësimin komunal;

8. Siguron një sistem komunikimi që mundëson rrjedhën e informacionit ndërmjet pikëpamjeve të fëmijëve që konfirmon se janë duke u respektuar në punën e tij dhe në punën e mbarë qeverisjes në nivel komunal;
9. Siguron një sistem komunikimi që mundëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve komunale dhe njësive specifike të institucioneve relevante përgjegjëse për çështjet e fëmijëve, bën rekomandime për të vepruar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve;
10. Rekomandon krijimin e organeve, ekipeve dhe mekanizmave tjerë, qofshin ato të përkohshme apo të përhershme, të orientuara në aspekte të veçanta të të drejtave të fëmijëve.
11. Njësitë do të shërbejnë si trup koordinues i të gjithë trupave tjerë që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe i përgjigjet Kryetarit të Komunës.

Neni 7

Themelimi i 'Tryezës Shumëdisiplinëshe për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit'

1. 'Tryeza shumëdisiplinëshe për ndihmë në menaxhimin e rasteve' themelohet në Komunën e Fushë-Kosovë në nivel profesionistësh.
2. 'Tryeza shumëdisiplinëshe për ndihmë në menaxhimin e rasteve' udhëhiqet nga Menaxheri i Rastit, në koordinim dhe bashkëveprim me strukturat dhe shërbimet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 8

Vlerësimi i ndikimit tek fëmijët

1. Komuna zhvillon një proces për vlerësimin e ndikimit të politikave, legjislacionit, planeve të veprimit dhe programeve për të drejtat e fëmijëve.
2. Ky proces vlerëson situatën e të gjithë fëmijëve, pa dallim.
3. Sigurohet që vlerësimi i ndikimit tek fëmijët fillon mjaft herët, gjatë analizës së situatës dhe formulimit të ndërhyrjeve për të pasur ndikim në vendimmarrje.
4. Kryhet një vlerësim i rregullt i ndikimit të aspekteve të qeverisë lokale tek fëmijët.
5. Sigurohet një hapësirë për procesin e pavarur të vlerësimit në lidhje me ndikimin e politikave në praktikat dhe shërbimet për fëmijë.

Neni 9

Sistemi i raportimit të rregullt për gjendjen e fëmijëve

1. Kryetari i Komunës i raporton Kuvendit të Komunës për të siguruar funksionimin efektiv të njësimit të koordinimit dhe raportimin e rregullt për të drejtat e fëmijës.
2. 'Njësiti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore' përcakton treguesit dhe të dhënat që janë prioritete të komunës për fëmijët dhe interesat e tyre. Ky mekanizëm obligon komunën të raportojë në mënyrë periodike për treguesit dhe të asistojë në kontrollin dhe vlerësimin e progresit për një 'Komunë mike për fëmijët'.
3. Komuna i përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve komunale në mbledhjen e të dhënave dhe raportimin nga sektorët përkatës, të lidhura me Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në rast kur Komuna nuk ka të dhëna të mjaftueshme, ata janë të obliguar t'i sigurojnë ato në bashkëpunim me nivelin qendror.
4. 'Njësiti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore' është përgjegjës për të nxjerrë të dhëna për raportim të rregullt për statusin e treguesve, të cilët sigurohen nga institucionet përgjegjëse komunale dhe u raportohet zyrtarisht në bazë vjetore.
5. Komuna i shfrytëzon në mënyrë efektive raportet për të zhvilluar politika, plane të veprimit, buxhetin për fëmijë, duke u bazuar në nevoja, kërkon nga njësiti përgjegjës t'i azhurnojnë të dhënat dhe raportimet në çdo kohë.
6. Bazuar në trendët e zhvillimit komunal, komuna i shqyrton treguesit dhe raporton periodikisht në mënyrë që t'i rishikojë ato, bazuar në nevojë.

Neni 10

Buxheti për fëmijë

1. Komuna zhvillon proces për analizimin e nevojave të buxhetit për fëmijët, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit. Ky proces përfshin:
 - 1.1. Identifikimin nëse fëmijët e komunës janë duke i pranuar pjesët e duhura të burimeve për investime publike, në shërbime, ku shpërndarja administrohet nga niveli i vendit;
 - 1.2. Analizën adekuate të buxhetit të përgjithshëm komunal dhe elementët brenda tij, në mënyrë që të zbulohet pjesa që është shpenzuar për fëmijë dhe të shfrytëzohen dëshmitë e gjeneruara për të investuar në fëmijë;
2. Komuna zhvillon proces për planifikim të buxhetit komunal i cili është transparent dhe bazohet në konsultime me palët, duke përfshirë edhe fëmijët. Ky buxhet reflekton nevojat për ndarjen e burimeve për fëmijë në të gjitha aspektet e qeverisjes komunale.
3. Komuna bënë analizë të ndarjes buxhetore për fëmijë ndër vite dhe tregon trendët e ndarjeve buxhetore për fëmijët.

Neni 11

Promovimi dhe ekspozimi më i dukshëm i çështjeve për të drejtat e fëmijëve

1. Komuna ndërmerr masa të qarta në mënyrë që të promovohen dhe respektohen të drejtat e fëmijëve, si nga fëmijët ashtu edhe nga të rriturit.
2. Masat për promovimin e të drejtave të fëmijëve përfshijnë (por nuk kufizohen në):
 - 2.1 Organizmin e trajnimeve në nivel komunal për të drejtat e fëmijëve;
 - 2.2 Përfshirjen e mësimit rreth të drejtave të fëmijëve sipas 'Konventës për të Drejtat e Fëmijëve' me bazë në shkollë;
 - 2.3 Përfshirjen e mësimit dhe promovimit të respektimit të të drejtave të fëmijëve në kuadër të programeve të trajnimit para dhe gjatë shërbimit, për persona të cilët punojnë me ose për fëmijë në nivel komunal;
3. Vlerësimin e rregullt të njohurive për të drejtat e fëmijëve në mesin e të rriturve dhe fëmijëve;
4. Paraqitja e punës së institucioneve të cilat e kanë për mandat ligjor, mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
5. Komuna krijon partneritete në bashkëpunim me institucionet qendrore, organizatat e shoqërisë civile, grupet e të rinjve dhe mediat për t'i promovuar të drejtat e fëmijëve.

Neni 12

Cilësia e shërbimeve për fëmijët në nevojë

1. Komuna ndërmerr masa për ofrimin e shërbimeve cilësore për fëmijët në nevojë sipas legjislacionit në fuqi.
2. Komuna bashkëpunon ngushtë me organizatat e shoqërisë civile të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Avokimi i pavarur për fëmijë

1. Komuna krijon sistem të qëndrueshëm të partneritetit me një spektër të gjerë të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të pavarura të cilat avokojnë për të drejtat e fëmijëve, në këtë drejtim:
 - 1.1. Organizatave të shoqërisë civile u jepet mbështetje adekuate financiare për të ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve të shërbimeve në fushën e të drejtave të fëmijëve;

- 1.2. Inkurajohen dhe mbështeten organizatat e të rinjve dhe fëmijëve;
 - 1.3. Lehtësohet themelimi i institucioneve të pavarura për të drejtat e fëmijëve;
 - 1.4. Mbahen komunikime të rregullta me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet e pavarura, në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e fëmijëve në komunë nga një perspektivë tjetër.
2. Kuvendi i Komunës organizon të paktën një seancë vjetore për t'i diskutuar çështjet e të drejtave të fëmijëve duke iu referuar raportit të situatës së tyre, sipas Nenit 8 të kësaj Rregulloreje.
 3. Komuna organizon 'Ditët mike për fëmijët' (të paktën 3 ditë në vit) dhe diskuton çështjet lidhur me të drejtat e fëmijës.

Neni 14 **Pjesëmarrja e fëmijës**

1. Komuna siguron pjesëmarrje aktive të fëmijëve në rastet me interes për ta në çdo proces vendimmarrës në nivel komune. Të gjithë zyrtarët publikë, institucionet dhe njësitë komunale institucionale janë të obliguara ta pasqyrojnë këtë në punën e tyre.
2. Institucionet edukative mundësojnë mësimin dhe praktikimin e pjesëmarrjes aktive përmes Kurrikulës së Shkollës - aktiviteteve ekstra-kurrikulare dhe në koordinim me institucionet e sektorëve përkatës të cilët janë drejtpërdrejt në kontakt me fëmijët gjatë ofrimit të shërbimeve për ta (shëndetësia, mirëqenia sociale, drejtësia, etj.).
3. Institucionet edukative, sportive dhe kulturore e nxisin krijimin dhe funksionimin e organizatave të fëmijëve dhe të rinjve, klubeve sportive, artistike dhe kulturore.
4. Organet administrative dhe gjyqësore në komunë, në rastin e vendimmarrjes për rastet që ndikojnë tek fëmijët, i marrin plotësisht parasysh pikëpamjet e fëmijëve dhe në përputhje me praktikën dhe udhëzimet e përcaktuara nga legjislacioni ekzistues, i përshtatshëm për moshën e tyre.
5. Në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e fëmijëve, komuna merr parasysh dhe bashkëvepron rregullisht me Asambleenë Komunale të Fëmijëve, si organ primar që përfaqëson në mënyrë të drejtpërdrejtë opinionet dhe pozitën e të gjithë fëmijëve, në veçanti më të cenuarve.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Procedurat për zbatimin e Rregullores

1. Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë së Administratës (Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore), Drejtorisë së Arsimit, Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe drejtorive tjera komunale.
2. Kuvendi i Komunës shqyrton dhe miraton Raportin Vjetor për nivelin e zbatimit të Rregullores dhe në rast të moszbatimit të saj merr vendime për masat eventuale për sigurimin e zbatimit të plotë të kësaj Rregulloreje.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore u miratua nga Kuvendi i Komunës, më datë _____ 2018, ndërsa hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Fushë-Kosovës.

Nr. _____ 2018

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjsha
